

Prof. Asoc. Dr. Eglantina Kalluçi

Zv/Dekane për Kurrikulat e Ciklit të Parë dhe të Dytë që prej vitit 2016. Diplomuar në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, DIND Matematikë (5-vjeçare) në vitin 2003. Fiton gradën Doktor i Shkencave në “Metoda Probabilitare, Statistike dhe Metoda të Analizës Numerike”, pranë Departamentit të Matematikës, Fakultetit i Shkencave të Natyrës.

Kërkimi shkencor dhe aktiviteti mësimor: Kontributi kërkimor me rreth 30 referime dhe publikime kombëtare dhe ndërkombëtare është i fokusuar në drejtimet: Metoda të Analizës Numerike, Programim Paralel, Simulime në Rrjetat Komplekse. Prej më shumë se 15 vitesh zhvillon leksione dhe seminare në lëndët Analizë Numerike, Analizë Numerike Matricore, Programim në Matlab, Programim Paralel dhe Simulimet Monte-Carlo për studentët e ciklit të parë dhe të dytë në programet e studimit “Inxhinieri Matematike dhe Informatikë”, “Matematikë”, “Informatikë” dhe “Teknologji Informacioni dhe komunikimi”.

Projekte, shkëmbime në mësimdhënie dhe kërkim: Kërkuese shkencore në projektin GRADUA (Graduates Advancement and Development of University capabilities in Albania) Erasmus+ prej vitit 2017, Koordinatorë për Shqipërinë në COST ACTION CA18131 “STATISTICAL AND MACHINE LEARNING IN HUMAN MICROBIOME”, anëtare në CA 18232 “MATHEMATICAL MODELS FOR INTERACTING DYNAMICS ON NETWORKS”. Ka kryer shkëmbime në mësimdhënie në Universitetin e Bologjës (2018), Universitetin e Grazit (2019) si dhe një kërkim shkencor pranë Universitetit të Selanikut (2007).

Botime dhe anëtarësime: Autore dhe bashkëautore në tekste universitare dhe parauniversitare, si dhe përkthyes dhe përshtatës në tekstet parauniversitare të Matematikës. Anëtare në disa shoqata kombëtare dhe ndërkombëtare.